

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 04/2009 i Misionit të OSBE-së në Kosovë i monitorimit të Kuvendit të Kosovës 1 korrik 2009 – 30 shtator 2009

Pikat kryesore

- Kuvendi themelon tri komisione të përhershme
- Kuvendi ratifikon marrëveshjen për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore
- Kuvendi debaton për gjendjen aktuale në RTK
- Kuvendi përballlet me vështirësi në menaxhimin e periudhës kohore për parashtrimin e pyetjeve parlamentare

1. Historiku

Raporti i 64-të i monitorimit është hartuar në pajtim me kushtet e referimit të Monitorimit të Kuvendit të Kosovës nga Shtylla e III-të e UNMIK-ut për Ndërtimin e Institucioneve (OSBE), të datës 26 nëntor 2002, dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e Punës, të miratuar në seancën plenare më 20 maj 2005, të amendamentuar në seancën plenare më 1-2 qershor 2006 dhe në seancën plenare të radhës, më 18 shtator 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar gjashtë seanca të rregullta plenare, që janë mbajtur më 9-10 qershor, më 17, 20 korrik, më 23 korrik, më 24 korrik, më 17 shtator dhe më 30 shtator, 1 tetor, si dhe shtatë takime të Kryesisë, që janë mbajtur më 1 korrik, më 7 korrik, më 14 korrik, më 21 korrik, më 28 korrik, më 8 shtator dhe më 22 shtator. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar 27 nga 30 takime të komisioneve.

2. Përmbledhje

Seancën plenare më 9-10 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (Partia Demokratike e Kosovës - PDK), dhe anëtari i Kryesisë, z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 9-10 korrik.¹
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 9-10 korrik:
 - Fjalimi vjetor i Presidentit të Kosovës
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Kosovës (Projektligji u miratua në parim me 46 vota për, dhe 18 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave (Projektligji u miratua në parim me 54 vota për, dhe tetë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale (Projektligji u miratua në parim me 45 vota për, dhe 14 vota kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për duhanin

¹ Numri që e tha Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës plenare.

- (Projektligji u miratua në parim me 46 vota për, dhe shtatë vota kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit
(Projektligji u miratua në parim me 54 vota për, dhe 11 vota kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik
(Projektligji u miratua në parim me 63 vota për, dhe dy vota kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave
(Projektligji iu kthye propozuesit për rihartim)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar
(Projektligji u miratua me 57 vota për, dhe tri vota kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Kosovë
(Projektligji u miratua me 53 vota për, dhe pesë vota kundër)
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët
(Raporti u miratua me 54 për, dhe 14 vota kundër)
- Shqyrtimi i rekomandimeve të komisionit *ad hoc* lidhur me emërimin e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës
(Emërimi u miratua me 39 vota për²)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Zyrës së rregullatorit për ujërat dhe mbeturinat
(Emërimet u refuzuan me 26 vota për, dhe 31 vota kundër.)
- Shqyrtimi i dokumentit “Letra e bardhë: Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë”
(Dokumenti u miratua me 58 vota për, dhe asnjë votë kundër)
- Informata e grupit parlamentar të Partisë Liberale të Pavarur (SLS) lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve të komisionit parlamentar

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 17, 20 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë, z. Sabri Hamiti (Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK).

- Shtatëdhjetë e dy deputetë të Kuvendit ishin të pranishëm në seancën plenare më 17, 20 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 17, 20 korrik:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Planin e Veprimit të Kuvendit mbi sfidat e Raportit të Progresit 2008 të Komisionit Evropian.
(Rekomandimet u miratuan me 67 vota për, dhe dy vota kundër)
 - Shqyrtimi i raportit të audituar të Trustit të kursimeve pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008
(Raporti u miratua me 43 vota për, dhe tetë vota kundër)
 - Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008
(Raporti u miratua me 59 vota për, dhe tetë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008.
(Raporti u miratua me 58 vota për, dhe gjashtë vota kundër)
 - Debati për gjendjen aktuale në Radio Televizionin e Kosovës (RTK)

² Komisioni *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i propozoi Kuvendit dy kandidatë, znj. Sabile Abdyli dhe z. Ali Dragusha, për t’i marrë në konsideratë për emërim. Në votim të fshehtë, znj. Abdyli mori 39 vota, z. Dragusha mori 25 vota, kurse 10 vota ishin të pavlefshme. Prandaj, z. Abdyli u emërua anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

(Debati që e hapi z. Arsim Rexhepi (LDK), propozues i debatit, u përcoll me diskutim të gjerë plenar dhe u përmbyll me një deklaratë të z. Rexhepi.)

- Informata e grupit parlamentar 7+ lidhur me zëvendësimin e një anëtari të komisionit

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 23 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë, z. Ibrahim Gashi (Aleanca Kosova e Re - AKR).

- Tetëdhjetë e një deputetë të Kuvendit ishin të pranishëm në seancën plenare më 23 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 23 korrik:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Ratifikimi i marrëveshjes për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore
(Marrëveshja u ratifikua me 89 vota për, dhe asnjë votë kundër)
 - Ratifikimi i marrëveshjes për përvetësimin e kredisë mes Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim dhe memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore
(Marrëveshja u ratifikua me 82 vota për, dhe një votë kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të zbatueshëm për buxhetin e Kosovës për vitin 2009
(Projektligji u miratua në parim me 62 vota për, dhe 30 vota kundër)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të komisionit *ad hoc* lidhur me emërimin e anëtarit serb të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.
(Emërimi u miratua me 44 vota për.³)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
(Projektligji u miratua në parim me 61 vota për, dhe me 11 vota kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit
(Projektligji u miratua në parim me 69 vota për, dhe me dy vota kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale
(Projektligji u miratua në parim me 68 vota për, dhe me dy vota kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara
(Projektligji u miratua në parim me 65 vota për, dhe me asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik
(Projektligji u miratua në parim me 81 vota për, dhe asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për shpalljen e hapësirës ku do të ndërtohet hidrocentrali “Zhur/Žur” si zonë me interes të veçantë ekonomik
(Propozimi u miratua me 69 vota për, dhe me tetë vota kundër)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 24 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë, z. Naim Maloku (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK).

- Gjashtëdhjetë e gjashtë deputetë të Kuvendit ishin të pranishëm në seancën plenare më 24 korrik.

³ Komisioni *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Pavarur Mbikëqyrës i propozoi Kuvendit dy kandidatë, znj. Irena Svetić – Ahmedi dhe z. Nebojša Azdejković, që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës, për t'i marrë në konsideratë për emërim. Në votim të fshehtë, znj. Svetić – Ahmedi mori 44 vota, z. Azdejković mori 40 vota, kurse 8 vota ishin të pavlefshme. Prandaj, znj. Svetić – Ahmedi u emërua anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 24 korrik:
 - Shqyrtimi dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të zbatueshëm për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 (Projektligji u miratua me 69 vota për, dhe me pesë vota kundër)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik (Projektligji u miratua me 70 vota për, dhe dy vota kundër)
 - Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Kuvendit për formimin e tri komisioneve të reja të përhershme⁴ (Propozimi u miratua me 81 vota për, dhe me një votë kundër)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Emërimet u miratuan me 68 vota për, dhe 10 vota kundër)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 17 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë, z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Tetëdhjetë e një deputetë të Kuvendit ishin të pranishëm në seancën plenare më 17 shtator
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 17 shtator:
 - Pyetjet që iu parashtruan qeverisë për përgjigje verbale
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizëm dhe shërbimet turistike (Projektligji u miratua në parim me 64 vota për, dhe me asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi dytë i Projektligjit për auditim të brendshëm (Projektligji u miratua me 67 vota për, dhe me asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike (Projektligji u miratua me 68 vota për, dhe me asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët (Projektligji u miratua me 64 vota për, dhe me 13 vota kundër)
 - Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (Emërimet u miratuan me 32 vota për, dhe me 28 vota kundër)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 30 shtator, 1 tetor e kryesuan dy anëtarë të Kryesisë, z. Eqrem Kryeziu (LDK) dhe z. Naim Maloku (AAK).

- Gjashtëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit ishin të pranishëm në seancën plenare më 30 shtator dhe 1 tetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 30 shtator, 1 tetor:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizimin (Projektligji u miratua me 62 vota për, dhe me asnjë votë kundër)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazin natyror (Projektligji u miratua me 65 vota për, dhe me asnjë votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë (Projektligji u miratua me 65 vota për, dhe me asnjë votë kundër)

⁴ Kuvendi themeloi tri komisione të përhershme: Komisionin për mbikëqyrjen e financave publike, Komisionin për mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë dhe Komisionin për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës (Rekomandimi u refuzua me 25 vota për, dhe 31 vota kundër)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me transferimin e mjeteve financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (Rekomandimi u miratua me 66 vota për, dhe asnjë votë kundër)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me numrin e punëtorëve të ekipeve komunale përgatitore për zgjedhje (Rekomandimi u miratua me 68 vota për, dhe asnjë votë kundër)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me korigjimin e numrit të punëtorëve në Autoritetin e Aviacionit Civil⁵ (Rekomandimi u miratua me 42 vota për, dhe tetë vota kundër)
- Shqyrtimi i raportit të punës së Bankës Qendrore për vitin 2008 (Me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së, kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së Ministrit për financa dhe ekonomi)
- Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mospranisë së qeverisë.)

3. Praktika parlamentare dhe zhvillimi i seancave të Kuvendit

Procesi legjislativ

- Projektligji për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar është miratuar gati tre muaj pas miratimit të tij në shqyrtimin e parë, në seancën plenare të mbajtur më 16 prill. Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Kosovë është miratuar katër muaj pas miratimit të tij në shqyrtimin e parë në seancën plenare të mbajtur më 12 mars. Projektligji për ndryshimin e ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 është miratuar një ditë pas miratimit të tij në shqyrtimin e parë në seancën plenare të mbajtur më 23 korrik. Projektligji për ndryshimin e ligjit për prokurimin publik është miratuar dy javë pas miratimit të tij në shqyrtimin e parë në seancën plenare të mbajtur më 9 korrik. Projektligji për auditim të brendshëm dhe Projektligji për gazin natyror janë aprovuar tetë muaj pas shqyrtimit të parë në seancën plenare të mbajtur më 29 janar. Projektligji për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe Projektligji për armët janë aprovuar pesë muaj pas shqyrtimit të parë në seancën plenare të mbajtur më 16 prill. Projektligji për standardizimin dhe Projektligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë janë aprovuar katër muaj e gjysmë pas shqyrtimit të parë në seancën plenare të mbajtur më 14 maj.

Rregulla 35.6 thotë: “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Shumica e projektligjeve të lartpërmendura u miratuan nga Kuvendi shumë kohë pas kalimit të afatit të caktuar me rregullën 35.6 dhe komisionet funksionale përgjegjëse nuk kërkuan kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi, gjë që nuk ishte në pajtim me rregullën 35.6. Shumë raporte të mëparshme të monitorimit kanë vërejtur njëloj që komisionet e Kuvendit kanë vështirësi për t'i shqyrtuar dhe raportuar rekomandimet e tyre rreth projektligjeve brenda afatit të caktuar me rregullën 35.6. Prandaj, Kuvendi do të mund ta merrte në konsideratë zgjatjen e afatit dymuajsh ose angazhimin e më shumë

⁵ Në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2009, Ministria e Ekonomisë dhe Financave kërkoi nga Kuvendi i Kosovës që ta lejojë rritjen e numrit të punëtorëve në Autoritetin e Aviacionit Civil. Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa e shqyrtoi kërkesën në fjalë dhe rekomandoi që ajo të miratohet.

punonjësve mbështetës dhe ekspertëve ligjorë për t'i ndihmuar komisionet që t'i shqyrtojnë projektligjet me kohë.

- Në seancën plenare më 9 korrik, Znj. Myzejene Selmani (AKR), Kryesuese e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion, propozoi që Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave duhet t'i kthehet propozuesit të ligjit për rihartim. Ajo deklaroi që projektligji në fjalë ka implikime të mëdha financiare që e bëjnë zbatimin e tij të pamundshëm, si dhe ka shumë gabime ligjore dhe substanciale. Kryetari i Kuvendi parashtrori për votim propozimin e znj. Selmani, i cili është miratuar me 31 vota për dhe 4 vota kundër.

Sipas Rregullës 35.3 “Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim (e theksuar).” Sipas kësaj analogjie, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion duhet t'i kishte propozuar Kuvendit kthimin e Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave te propozuesi, në pajtim me Rregullën 35.3. Për më tepër, Rregulla 35.7 thotë: “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare”(e theksuar). Nëse Komisioni i lartpërmendur do ta kishte shqyrtuar projektligjin në fjalë gjatë shqyrtimit të parë, siç edhe lejohet me Rregullën 35.7 ,atëherë ai do ta kishte pasur mundësinë t'i vërejë gabimet në projektligj dhe do ta kishte pasur mundësinë ta propozojë kthimin e tij te propozuesi gjatë shqyrtimit të parë, në vend se të parashtrrojë një propozim të tillë pesë muaj pas shqyrtimit të parë. Rekomandohet fuqimisht që komisionet e Kuvendit ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të parë në mënyrë që procesi legjislativ të jetë më efikas.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për ndryshimin e ligjit për duhanin, Projektligji kundër korrupsionit, Projektligji për dhënie e dekoratave nga Presidenti i Kosovës dhe Projektligji për ndryshimin e ligjit për prokurim publik janë shpërndarë më 16 qershor, Projektligji për minerale dhe miniera është shpërndarë më 17 qershor dhe Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave është shpërndarë më 19 qershor. Pra, projektligjet janë shpërndarë 16, 15 dhe 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 9 korrik. Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është shpërndarë më 16 qershor, Projektligji për tatimin në të ardhura personale është shpërndarë më 29 korrik, Projektligji për financimin e programeve të veçanta të banimit është shpërndarë më 30 qershor, Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara dhe Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik janë shpërndarë më 10 korrik, dhe Projektligji për ndryshimin e ligjit të zbatueshëm për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 është shpërndarë më 15 korrik. Pra, projektligjet janë shpërndarë 26, 17, 16, tetë dhe pesë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 23 korrik. Projektligji për turizmin dhe shërbimet turistike është shpërndarë më 26 gusht. Pra, projektligji është shpërndarë 15 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare më 17 shtator.

Rregulla 35.1 kërkon që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Pesë nga projektligjet e lartpërmendura – Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Projektligji për tatimin në të ardhura personale, Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe Projektligji për ndryshimin e ligjit të zbatueshëm për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 – nuk janë shqyrtuar në shqyrtimin e parë sipas Rregullës 35.1. Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe Projektligji për tatimin

në të ardhura personale janë shqyrtuar në shqyrtimin e parë pas më shumë se tri javë pune pas shpërndarjes së tyre kurse shqyrtimi i parë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe Projektligjit për ndryshimin e ligjit në fuqi për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 është mbajtur më herët se dhjetë ditë pune pas shpërndarjes së tyre dhe nuk i ka ofruar kohë të mjaftueshme anëtarëve të komisionit për t'i studiuar projektligjet në fjalë.

Kuvendi themelon tri komisione të reja

- Në seancën plenare më 24 korrik, sipas propozimit të Kryesisë, Kuvendi miratoi formimin e tri komisioneve të reja parlamentare. Propozimi u miratua me 81 vota për dhe një votë kundër. Tri komisionet e reja janë: Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, Komisioni për mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë dhe Komisioni për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Kryesia e Kuvendit vendosi që tri komisionet e reja do të kenë nga nëntë anëtarë – nga dy nga grupet parlamentare të LDK-së dhe PDK-së, dhe nga një nga grupet parlamentare të AAK-së, AKR-së, LDD-së, SLS-së dhe grupit parlamentar 7+.

Vendimi i Kuvendit për t'i themeluar tri komisione të reja ishte në pajtim me Rregullën 41.1, sipas së cilës Kuvendi i Kosovës vendos, sipas propozimit të Kryesisë, për numrin e komisioneve dhe strukturën e tyre.

Debati për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës

- Më 20 korrik, gjatë vazhdimit të seancës plenare të 17 korrikut, Kuvendi debatoi për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në bazë të mocionit të tetë deputetëve të Kuvendit.⁶ Në mocionin e tyre, deputetët pohuan se Bordi i RTK-së kishte shkëlur Ligjin për RTK-në, Ligjin për prokurimin publik dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënien në lidhje me punësimin dhe procedurat e tenderimit. Gjithashtu, ata i rekomanduan Kuvendit që ta shkarkojë Bordin e RTK-së dhe ta caktojë një bord të ri të përkohshëm, si dhe ta formojë një komision hetimor *ad hoc* për t'i hetuar shpenzimet financiare të RTK-së. Në deklaratën e tij hyrëse, z. Arsim Rexhepi (LDK), si propozues i debatit, tha që edhe deputetë tjerë e kishin nënshkruar në ndërkohë kërkesën për formimin e një komisioni hetimor, duke e rritur kështu numrin e deputetëve nënshkrues në 44. Kryetari i Kuvendit i përkujtoi deputetët në fjalë që Kuvendi nuk ka kompetencë për ta shkarkuar Bordin e RTK-së. Në lidhje me formimin e një komisioni hetimor *ad hoc*, Kryetari i Kuvendit theksoi se kërkesa nuk e kishte mbështetjen e nevojshme të së paku 40 deputetëve për shkak se nëntë deputetë e kishin tërhequr mbështetjen e tyre, duke lënë kështu kërkesën me vetëm 35 nënshkrime. Prandaj, Kryetari i Kuvendit nuk e parashtruar kërkesat e lartpërmendura për votim.

Sipas nenit 25.2 (a) të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/14 më 11 prill 2006, shkarkimi i një anëtari të Bordit të RTK-së propozohet nga vetë Bordi i RTK-së me kërkesë të 2/3 të numrit të anëtarëve të Bordit. Gjithashtu, neni 25.2 (b) thotë që Kuvendi i Kosovës, pas propozimit të Bordit të RTK-së, vendos me shumicë të thjeshtë për shkarkimin e një anëtari të Bordit. Është e qartë se nuk është kompetencë e Kuvendit që ta iniciojë procedurën për shkarkimin e Bordit të RTK-së apo ndonjë anëtari të tij. Prandaj, kërkesa e deputetëve të lartpërmendur drejtuar Kuvendit nuk ishte në pajtim me Ligjin për RTK-në.

⁶ Më 10 qershor, tetë deputetë të Kuvendit parashtruan një mocion për debat parlamentar për RTK-në. Ata ishin: z. Arsim Rexhepi (LDK), z. Riza Smakaj (AKR), z. Gani Geci (LDD), z. Naser Rugova (LDD), z. Shkumbin Demaliaj (AAK), z. Naim Rrustemi (deputet i pavarur/ish anëtar i PDK), z. Driton Tali (deputet i pavarur/ish anëtar i AKR-së) dhe z. Emrush Xhemajli (Partia Socialiste [PS]/ish anëtar i Grupit Parlamentar të PDK-së).

Për më tepër, edhe kërkesa për formimin e një komisioni hetimor nuk i ka përmbushur kriteret e caktuara në nenin 77.2 të kushtetutës, sipas së cilës Kuvendi i cakton komisionet për çështjet e veçanta, duke përfshirë edhe çështjet hetimore, në bazë të kërkesës së 1/3 së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, që do të thotë së paku 40 prej tyre.

Kuvendi vazhdon të ballafaqohet me vështirësi në menaxhimin e kohës për pyetje parlamentare

- Në seancën plenare më 9-10 korrik, u dhanë përgjigje në vetëm shtatë nga 22 pyetje parlamentare ndërsa 15 pyetjet tjera u shtynë për seancën e ardhshme plenare për shkak se Kryeministri dhe disa ministra nuk ishin të pranishëm për t'u përgjigjur. Në seancën plenare më 17-20 korrik, u dhanë përgjigje në nëntë nga 13 pyetje parlamentare. Në seancën plenare më 23-24 korrik, u dhanë përgjigje në dy nga pesë pyetje për shkak se dy deputetë nuk ishin të pranishëm për t'i parashtruar pyetjet e tyre, kurse një deputet tjetër vendosi që ta parashtrojë pyetjen në seancën e ardhshme plenare. Në seancën plenare më 17 shtator, u dhanë përgjigje në nëntë pyetje. Në seancën plenare më 30 shtator, u dhanë përgjigje në nëntë nga 16 pyetje parlamentare ndërsa shtatë pyetje mbetën pa përgjigje për shkak se ministri përkatës nuk ishte i pranishëm për t'u përgjigjur apo për shkak se deputeti përkatës nuk ishte i pranishëm për ta parashtruar pyetjen. Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi i seancës kanë deklaruar se pyetjet ndaj të cilave nuk është dhënë përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.⁷

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, koha për pyetje është zbatuar nga Kuvendi në pajtim me rregullën 26 mbi "Pyetjet për Qeverinë për Përgjigje me Gojë", sipas së cilës rendi i ditës për secilën seancë përfshin një periudhë për pyetje deri në 50 minuta për pyetjet e anëtarëve të Kuvendit për qeverinë, me një minutë për një pyetje, tre minuta për përgjigjen e ministrit, dhe një minutë për pyetje plotësuese dhe dy minuta për përgjigje ndaj pyetjes plotësuese.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, sikur edhe më parë, është vërejtur që të gjitha pyetjet nuk mund të shqyrtohen brenda periudhës prej 50 minutash për shkak të numrit të madh të pyetjeve që i parashtrojnë anëtarët e Kuvendit. OSBE-ja ka rekomanduar më parë që Kuvendi duhet ta zgjasë kohën e pyetjeve dhe/ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për një anëtar, në mënyrë që të gjithë anëtarëve që kanë parashtruar pyetje t'u jepet mundësia që t'i paraqesin ato me kohë dhe të marrin përgjigje. Vlen të theksohet se Komisioni për Rregulloren e Punës ka përfshirë dispozita të reja në projekt-rregulloren e re të punës, sipas të cilave koha e pyetjeve do të kufizohet deri në 60 minuta dhe që një anëtar i Kuvendit do të ketë të drejtën t'i parashtrojë vetëm dy pyetjeve gjatë një seance plenare. Dispozitat e reja kanë për qëllim që koha e pyetjeve parlamentare të jetë më efikase duke u dhënë anëtarëve që parashtrojnë pyetje një mundësi më të mirë për të marrë përgjigje me kohë. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar dy vite nga fillimi i mandatit të Kuvendit aktual, projekt-rregullorja e re e punës ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Rekomandohet fuqimisht që Kuvendi ta miratojë rregulloren e re të punës për t'i kryer detyrat e tij në mënyrë sa më efikase.

⁷ Në korrik, Kuvendi i Kosovës ka filluar publikimin e një reviste të re të quajtur *Kuvendi*, që e zëvendësoi Buletinin e Kuvendit. Misioni i OSBE në Kosovë e ka mbështetur Kuvendin e Kosovës në publikimin e kësaj reviste, duke e mundësuar bartjen e praktikave të mira të zhvilluara gjatë shtatë viteve të publikimit të buletinit informativ të Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit (ASI). Këto praktika të mira përfshijnë krijimin e një bordi redaktorial, përmirësimin e kualitetit të dizajnit të Buletinit të Kuvendit, zhvillimin e revistës në gjuhën angleze, rritjen e kualitetit të shkrimeve dhe gjetjen e kanaleve të reja të shpërndarjes. Me mbështetje të Misionit të OSBE-së, Kuvendi i Kosovës e ka themeluar bordin redaktorial, të përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, Zyrës së Kryetarit të Kuvendit dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që e përkrahin punën e Kuvendit. Revista e re e Kuvendit mund të sigurohet në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës www.assembly-kosova.org, e publikuar në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe turke.

4. Qasja

- Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Misioni i OSBE në Kosovë ka pasur qasje në seancat plenare, takimet e Kryesisë së Kuvendit dhe takimet e komisioneve që u shqyrtuan në këtë raport. Po ashtu, Misioni i OSBE në Kosovë ka pranuar kopjet e dokumenteve që i ka shqyrtuar Kuvendi, si dhe transkriptet e seancave plenare.

5. Transparenca

- Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Kuvendi nuk i ka publikuar të dhënat e votimit elektronik të asnjë seance plenare. Kuvendi i ka publikuar të dhënat e votimit elektronik të disa seancave plenare para kësaj periudhe, por nuk e ka vazhduar këtë praktikë më vonë. Publikimi i të dhënave të votimit elektronik është një hap i rëndësishëm në rritjen e transparencës së Kuvendit, posaçërisht për llogaridhënien e deputetëve ndaj zgjedhësve të tyre. Prandaj, rekomandohet që Kuvendi të publikojë vazhdimisht të dhënat e votimit elektronik.⁸
- Radio Televizioni i Kosovës ka ofruar mbulim dhe transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare që u shqyrtuan në këtë raport. Anëtarët e monitoruesve publikë dhe institucionalë kanë pasur qasje në seancat plenare. Kuvendi ka një ueb-faqe www.assembly-kosova.org, që përmban të dhënat biografike të deputetëve, informata për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbalet dhe transkriptet e seancave të Kuvendit dhe takimeve të komisioneve, kopjet e ligjeve, rezolutat dhe deklaratat e miratuara nga Kuvendi dhe informata tjera.

PËRFUNDON.

⁸ Në seancën plenare më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit theksoi që Kuvendi do të publikojë në ueb faqen e tij të dhënat e votimit elektronik për vendimet në seancat plenare. Pas kësaj, Kuvendi filloi t'i publikojë të dhënat e votimit elektronik prej seancës së jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008. Sidoqoftë, të dhënat e votimit elektronik nuk janë publikuar vazhdimisht.